



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. I menaxherit të Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërin anë;

dhe

"CONSRUCTION GROUP" Shpk nga Prishtina, të cilën e përfaqëson, z. Arjeta Aliti, me Nr. Rexh. Biznesi, 810831645 (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I KANALIZIMIT NE GURRAKOC

Nr. Prokurimit	633-20/3649 / 521/ C390
Nr. I brendshëm	633 / 20 / 044 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I KANALIZIMIT NE GURRAKOC

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi I kontratës për punimet **NDËRTIMI I KANALIZIMIT NE GURRAKOC** është: 19.876,40 € dhe me fjalë:

/Nëntëmbëdhjetëmijëtetëçindeeshtatëdhjetëeegjashtë 40/ €

2.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralloqaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet në afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 24. 12. 2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet për dëmet eventuale të shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim,

miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetohet", "miratohet" ose "vendoset" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për kontraktorin:

"CONSTRUCTION GROUP" Shpk

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	ARJETA ALITI
Pozita:	U.D. Menaxherit të Prokurimit	Pozita:	Drejtore,
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data	05. 11. 2020	Data	05. 11. 2020
Vula:		Vula	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontratës.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtës do të jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtës do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtës pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>2muaj</i>
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>5DITE</i> pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të provojnë në mënyrë miqësore të zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

NDERTIMI I KANALIZIMIT NE GURRAKOC

Nr.	Titulli	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (me TVSh)	Totali (me TVSh)
1	Hapja e kantierit që përfshin të gjitha objektet e nevojshme për përcjelljen e ndërtimit të objektit.	TOTAL	1.0	50.0	50.00
2	Pastrimi I terrenit pergjate trases se kanalizimit nga te gjitha pengesat si shkurret, lisat dhe te tjera	m'	1,250.0	0.3	375.00
3	Riincizimi i trasës. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet riincizimi i trasësë kanalizimit dhe definimin numerik të saj me të gjithë elemente e domosdoshëm (thyrjen horizontale, lidhjet etj). Mjetet gjeodezike jane te nevojshme, per arsye te disniveleve te terrenit.	m'	1,250.0	0.1	125.00
4	Largimi i Lisave, qe gjinden ne kanal, hapja e rruges, per punimin e kanalit. Kthimi ne gjendje te mire, e rruges. Mbushja me zhavor e rruges per kalimin e Bujqeve. Lisat janë te dendur.	m'	620.0	1.0	620.00
5	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Thellesia mesatare $H=2.5-3.0$ m', per shkak te disniveleit te terrenit. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjeherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalën në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar ura për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritet gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali.Me makine 90%.	M3	3,000.0	0.8	2,400.00
6	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Thellesia mesatare $H=2.5-3.0$ m', per shkak te disniveleit te terrenit. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjeherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalën në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar ura për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritet gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali me dore 10%.	m3	350.0	0.8	280.00
7	Sigurimi i kanalit nga shembja. Sigurimi i kanalit nga rreshqitja është e domosdoshme, pasi qe punimet duhet të bëhen nën nivelin e Lumit. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit.	m'	1,250.0	0.2	250.00
8	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ± 1 cm.	m2	1,000.0	0.1	100.00
9	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi në vend qe është caktuar nga organi mbikqyrës mbi 5km.	m3	1,297.0	0.2	259.40
10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa.	m3	400.0	2.0	800.00



11	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit (0-60)mm , për mbushjen e kanalit në pjesen ku kanalizimi punohet pergjate konstruksionit të rrugës dhe ku kemi mbushje. Mbushja është e nevojshme per kalimin e bujqve. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%.	m3	250.0	2.5	625.00
12	Mbulimi i kanalit me materialin e gërmuar nga kanali në shtresa 30cm me ngjeshje adekuate.	m3	760.0	0.3	228.00
13	Largimi i ujërave nëntokësore nga kanali gjate punimeve me pompa. Uji gjindet ne tere gjatesin e trases, pasi qe traseja kalon afer kanalit te Limit.	TOTAL	1.0	100.0	100.00
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 O 315 - fekal.	M	1,250.0	7.0	8,750.00
15	Vendosja e shiritit sinjalizues. Shiriti duhet të vendoset min 50cm mbi gyp. Në këtë gyp duhet të shkruhet në gjuhën shqipe KUJDES GYP I KANALIZIMIT.	m'	1,250.0	0.1	125.00
16	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20 25 d=20cm.	m3	15.6	20.0	312.00
17	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	m3	13.2	20.0	264.00
18	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar O1000 1000mm (elemente të parafabrikuara).	copë	70.0	15.0	1,050.00
19	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit O1000 700 600mm (elemente të parafabrikuara).	copë	35.0	15.0	525.00
20	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës O19 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	copë	280.0	0.1	28.00
21	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej betonarme. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20 25.	copë	35.0	10.0	350.00
22	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik O400 per kalimin e kanalit te lumit dhe asfaltit. Në çmim të llogaritet edhe shpimi i rruges ne vendet e caktuara. Gypi i metalit duhet te jete ne gjatesi L=6m', per kalimin e Lumit.	m'	38.0	25.0	950.00
23	Betoni dhe shtangimi i gypave te metalit me beton C20-25. Punimi i armatures-koshit te armatures. Pasi qe ne nje pjese gypi i hekurit duhet te konstruktohet ne hapsire. Betoni duhet me mbarret me dore, per shkak te konfiruracionit te terenit.	m3	15.0	25.0	375.00
24	Prerja e Asfaltit per gjetjen e gypit kryesor te kanalizimit, pas qe gupi ku kemi per tu lidhur, gjindet nen asfalt. Gypi ekzistues gjindet ne thelesin H=3.5 m', Gypi është nga materiali Azbest. Kthimi ne gjendjen e merarshme e rruges kyresore.	TOTAL	1.0	200.0	200.00
25	Devijimi i rrjedhjes kryesore te Lumit, deri sa te behet vendosja e gypit. Per arsyeje se Lumi ka rrjedheje te madhe te ujit. Pas perfundimit te punimeve rrjedhja e Lumit, kthehet ne gjendjen e meparshme.	m'	120.0	1.0	120.00
26	Hegja kubezave dhe rivendosja e kubezave prej betoni në gjendjen e meparshme. Duhet te behet nivelizimi i pusetave nivelit te oborreve.	m2	250.0	1.0	250.00
27	Thyerja e mureve te Betonit, ne rrethoja te objekteve, pas kryerjeve te punve, muri duhet te betpnohet perseri, si ne gjendjen e meparshme, vendosja e gilinderave ne hekuri.	m'	48.0	5.0	240.00
28	Testimi i rrjetit të kanalizimit në joujëlëshueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune.	m'	1,250.0	0.1	125.00
29	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT € 19,876.40				

